



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_260_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_433_07_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_433_07_10** ;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Isa Ethem (shifra e konsumatorit DPR - 90013727) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 12.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 20.01.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 28.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 7510875 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 1367963.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 2020 datë 28.02.2008

- Me datë 02.02.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7510875, ku është konstatuar se njehsori elektrik një vulë (bllombë) shtetërore i mungon kurse dy të tjera i ka në rregull, nga ana e jashtme qelqin e ka të hequr nga vendi si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa dhe gërvishtjes.

Provë: Procesverbali me nr. 18/2 i datës 02.02.2008

- Me datë 18.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik i konsumatorit është duke regjistruar shpenzim të energjisë elektrike dhe se vulat (bllombat) shtetërore janë në rregull..
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 182069 i datës 18.04.2008
- Me datë 23.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 182069 i datës 23.09.2008
- Me datë 11.11.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 171019 i datës 11.11.2008
- Me datë 12.12.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP07128 në vlerë prej 6,718.39 €.
Provë: Fatura DPR08HP07128 e datës 12.12.2008
- Me datë 22.12.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 20.01.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 20.01.2009
- Me datë 30.12.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Personat e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se, njehsori elektrik nr. 7510875 një vulë (bllombë) shtetërore i mungon kurse dy të tjera i ka në rregull, nga ana e jashtme qelqin e ka të larguar nga vendi si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa dhe gërvishtjes, ky konstatim është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë (përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo përfaqësuesve të institucioneve të pavarura) ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar.
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive shihet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri dhe me njehsor të vjetër ka ndryshim.
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës dimërore me njehsor të vjetër nr. 7510875 për periudhën 01/2007 – 03/2007 është **1297.67 kWh** për periudhën 01/2006 – 03/2006 është **1497.33 kWh** për periudhën 01/2005 – 03/2005 është **781.00 kWh** kurse me njehsor të ri nr. 1367963 për periudhën 01/2008 – 03/2008 është **723.33 kWh** dhe për periudhën 01/2009 – 03/2009 është **780.00 kWh**.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës verore me njehsor të vjetër nr. 7510875 për periudhën 4/2007 – 09/2007 është **1051.67 kWh**, për periudhën 04/2006 –

09/2006 është **1299.83 kWh** për periudhën 04/2005 – 09/2005 është **768.67 kWh** si dhe për periudhën 04/2004 – 09/2004 është **1012.83 kWh** kurse me njehsor të ri nr. 1367963 për periudhën 04/2008 – 09/2008 është **778.17 kWh** si dhe për periudhën 04/2009 – 09/2009 është 736.17 kWh.

Provë: Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudha të njëjta kohore me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri ka dallim pasi që shpenzimi i energjisë elektrike me njehsor të ri krahasuar me një vit mbrapa me njehsor të vjetër është më i vogël. Shpenzimi i energjisë elektrike me njehsor të ri për periudhën 01/2008 - 12/2008 është **760.58 kWh** kurse me njehsor të vjetër periudha 01/2007 – 12/2007 është **1024.17 kWh** e që e shprehur në përqindje ka një rrënjë të shpenzimit të energjisë elektrike prej **26%**, kurse krahasuar me vitet paraprahe: për periudhë 01/2006 – 12/2006 është **1345.00 kWh** e që e shprehur në përqindje ka rrënjë prej **43%**, për periudhën 01/2005 – 12/2005 është **849 kWh** e që e shprehur në përqindje ka një rrënjë prej **10 %**.

Provë: Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ DMK në ZRRE, bazuar në analizën e dokumentacionit të ofruar nga KEK-u ka vërejtur se ekziston mospërputhje mes datës së përpilimit të procesit të ndërrimit të njehsorit elektrik dhe datës së përpilimit të procesit nga qendra e kalibrimit. Ne vërtetimin me nr. 2020 të ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 7510875 figuron data 28.02.2008 kurse procesverbali me nr. 18/2 është përpiluar nga qendra e kalibrimit me datë 02.02.2008 gjë e cila paraqet mospërputhje pasi që shqyrtimi i njehsorit elektrik nuk mund të bëhet para ndërrimit të njehsorit elektrik.

- ✓ Bazuar në analizën e bërë listave të leximit, konstatohet se lexuesi i KEK-ut vetëm në muajin 12/2007 ka konstatuar se njehsori i konsumatorit është i dëmtuar përkatësisht qelqi i njehsorit elektrik është i thyer kurse deri në atë periudhë asnjëherë nuk ka konstatuar se njehsori elektrik është i dëmtuar në çfarëdo mënyre.

Provë: Listat e leximit

- ✓ Konsumatori në deklaratën pohon se njehsori elektrik i lokalit gjendet në ormanin e përbashkët të ndërtesës dhe se asnjëherë më herët nga askush përfshi lexuesit e KEK-ut nuk i është dhënë vërejtja se njehsori elektrik është i dëmtuar. Në rastin kur, lexuesi i KEK-ut më ka treguar se njehsori elektrik është dëmtuar unë kam vepruar sipas procedurave të rregullta që janë në fuqi duke kërkuar në mënyrë zyrtare nga KEK-u ndërrimin e njehsorit elektrik. Unë si konsumator dhe pagues i rregullt i energjisë elektrike deklaroj se nuk kam pasur asnjë motiv për të keqpërdorur energjinë elektrike dhe se edhe pas kësaj pa drejtësie nga ana e KEK-ut mbetem pagues i rregullt i energjisë elektrike.

Provë: Deklarata e konsumatorit

- ✓ DMK në ZRRE, bazuar në analizën e bërë kalkulimit të faturës së rikthimit të humbjeve të përpiluar nga departamenti i faturimit në KEK ka konstatuar se KEK-u ka gabuar ngase nuk ka respektuar nenin 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike por ka ngarkuar konsumatorin me faturën për rikthim të humbjeve DPR08HP07128 bazuar në seksionin e kabllit.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Rekomandimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_R_433_07_10 si dhe ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura dhe ka konstatuar se rekomandimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar